



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte, Trupi Gjykses më 18 shtator urdhëroi vazhdimin e paraburgimit për Rexhep Selimin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin, duke konstatuar se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses gjykoj se lirimi i të akuzuarve në posedim të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi tashmë ose të atyre që mund të dëshmojnë në procese paralele. Në rastin e z. Selimi, Trupi Gjykses rikujtoi se duket se z. Selimi nxori informacion konfidencial për palë të treta të paautorizuara, çka përforcoi konstatimin e Trupit Gjykses se ekziston rreziku që z. Selimi të pengojë ecurinë e procesit.

Sipas mendimit të Trupit Gjykses, rreziqet e identifikuar mund të zvogëlohen vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Trupi Gjykses mbajti parasysh se të akuzuarit gjenden në paraburgim për një kohë të gjatë, por vazhdimin e paraburgimit e gjykoj të arsyeshëm bazuar në faktet se ndaj të akuzuarve janë ngritur akuza për krime të rënda ndërkombëtare, ku pretendohet se ata luajtën rol të rëndësishëm dhe mund të përballen me burgim të gjatë në qoftë se shpallen fajtorë.

Gjatë kësaj jave dëshmitari i tretë i thirrur nga Mbrojtja e Thaçit dha dëshmi në sallë të gjyqit. John Duncan (Xhon Dankën) është një ish-punonjës i shërbimit diplomatik të Britanisë së Madhe. Ai dha dëshmi kryesisht në seancë publike.

Seanca e ardhshme në këtë çështje është caktuar për të hënë 29 shtator. Gjatë javës tjetër pritet që dy dëshmitarë të japin dëshmi në sallë të gjyqit.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, më 19 shtator, Prokuroria dorëzoi dosjen paraprake, sipas afatit të caktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Në një vendim të javës së kaluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ftoi ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë dosjet paraprake deri më 20 tetor dhe njoftoi se synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykses në gjysmën e parë të nëntorit, në varësi të vendimeve që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara këtë javë u takua me anëtarë të komunitetit vendor në Zveçan, si dhe me studentë, nxënës të shkollave të mesme dhe gazetarë në Prishtinë. Pothuajse çdo muaj, një ekip i Dhomave të Specializuara takohet me përfaqësues të shoqërisë civile në pjesë të ndryshme të Kosovës për të shpjeguar mandatin e Gjykatës, për t'u dhënë informacion të përditësuar për proceset dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 35/2025
Hagë, 25/09/2025

Më 21 shtator, Dhomat e Specializuara morën pjesën në *Ditën e Vizitave të Institucioneve* në Hagë, gjatë së cilës një herë në vit organizatat ndërkombëtare hapin dyert e tyre për publikun dhe shpjegojnë mandatin dhe aktivitetet e tyre. Gjatë ditës, Dhomat e Specializuara ofruan tri vizita të shoqëruara të pjesës publike të Gjykatës.

